

PËRMBLEDHJE E MINUTAVE TË MBLEDHJES

KËSHILLI I INVESTIMEVE (KI)

MBLEDHJA XXXVI

“Mbi Digjitalizimin e Shërbimeve Publike Vendore për Biznesin dhe

Aksesin në Tregun e Përbashkët Evropian”

Tiranë, 4 dhjetor 2025, 15:00 – 16:40

Mbledhja u drejtua nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, znj. Delina Ibrahimaj, Kryetare e Këshillit të Investimeve (KI). Në mbledhje morën pjesë 15 anëtarë të KI dhe 30 vëzhgues – përfaqësues të shoqatave të biznesit vendas dhe të huaj dhe institucioneve shtetërore në Shqipëri.

I. Hapja e Mbledhjes nga Ministria Delina Ibrahimaj, Kryetare e KI

Në fjalën e saj hyrëse, Ministria Ibrahimaj përshëndeti pjesëmarrësit dhe shprehu kënaqësinë për rikthimin në rolin e kryetares së Këshillit të Investimeve. Ajo vuri në dukje se viti i ardhshëm pritet të jetë veçanërisht sfidues, për shkak të volumit të madh të legjislacionit që duhet miratuar në kuadër të procesit të integritimit evropian—ku mbi 400 akte lidhen drejtpërdrejt me ekonominë dhe kërkesat që pritet të adresojnë bizneset shqiptare.

Ministria theksoi se kjo situatë sjell sfida, por edhe mundësi të rëndësishme për ekonominë dhe komunitetin e biznesit, duke nënvizuar rolin e anketimeve dhe analizave të Këshillit të Investimeve në identifikimin e sfidave dhe përcaktimin e veprimeve për t'i adresuar ato.

Duke iu referuar gjetjeve të anketës së fundit të Sekretariatit mbi klimën e biznesit, e cila do të prezantohej gjatë mbledhjes, ajo propozoi që në janar të zhvillohet një diskutim më i detajuar për ndarjen e detyrave dhe planifikimin e veprimeve konkrete, me qëllim që bizneset të jenë më të përgatitura për proceset në vijim dhe të shfrytëzojnë plotësisht potencialet ekzistuese.

Ajo falenderoi gjithashtu Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor, z. Ervin Demo, për praninë në këtë mbledhje, lidhur me pikën e parë të rendit të ditës që trajtonte digjitalizimin e shërbimeve në nivel vendor dhe koordinimin me pushtetin qendror.

II. Prioritetet dhe sfidat e digjitalizimit në nivel vendor

Ministri Ervin Demo theksoi rëndësinë e tryezave që ndërthurin interesat e biznesit me politikat publike, veçanërisht në nivel vendor, duke vënë në pah rolin kyç të bashkive në zhvillimin e territorit dhe në shfrytëzimin ekonomik të potencialeve lokale. Ai u ndal te gjetjet e anketimit të Sekretariatit, të cilat, sipas tij, pasqyrojnë qartë sfidat aktuale të bashkive. Digjitalizimi i shërbimeve vendore mbetet domosdoshmëri, por procesi përballet me sfida të tilla si fragmentimi territorial, kapacitetet e kufizuara dhe nevoja për standardizim të procedurave.

Ministri nënvizoi se digjitalizimi duhet të shoqërohet me ri-inxhinierim të proceseve, në mënyrë që ato të bëhen më transparente, më të thjeshta dhe më efikase. Ai theksoi se qeveria qendrore duhet të mbulojë kostot e investimeve – nga infrastruktura teknike të trajnimit dhe siguria kibernetike – ndërsa bashkitë duhet të fokusohen në ngritjen e kapaciteteve dhe mirëadministrimin e proceseve.

Ai përmendi reformat e parashikuara për vitin 2026, përfshirë reformën territoriale, e cila duhet të mbështetet në analiza dhe t'i garantojë bashkive kapacitete reale për zhvillim ekonomik. Po ashtu, theksoi rëndësinë e digjitalizimit të menaxhimit financiar të brendshëm të bashkive, në harmoni me skemën e grantit të performancës, e cila mbështetet nga partnerët ndërkombëtarë.

Ministri theksoi se digjitalizimi është thelbësor për transparencën dhe luftën kundër korrupsionit, dhe se procesi do të zhvillohet me konsultim të vazhdueshëm me komunitetin e biznesit. Ai propozoi që, sapo modeli i ri të jetë më i konsoliduar, t'i prezantohet Këshillit të Investimeve për të marrë komente dhe sugjerime. Në përfundim, ai vlerësoi se viti 2026 do të jetë veçanërisht sfidues për institucionet publike, bizneset dhe qytetarët, pasi iniciativat ligjore dhe reformuese do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë tek të gjithë aktorët.

III. Prezantim i Sekretariatit mbi Analizën për Digjitalizimin e Shërbimeve Vendore

Znj. Diana Leka (Angoni), Sekretariati i KI, paraqiti gjetjet dhe rekomandimet kryesore të analizës së Sekretariatit mbi digjitalizimin e shërbimeve administrative në nivel vendor. Problematika e trajtuar, e përzgjedhur nga anëtarët e Këshillit, evidenton boshllëqet midis nivelit qendror dhe vendor në ofrimin e shërbimeve digjitale.

Analiza tregon se digjitalizimi i shërbimeve vendore është ende i pabarabartë dhe i kufizuar krahasuar me nivelin qendror. Bizneset e vlerësojnë procesin në parim, por shprehin rezerva për funksionimin e sistemeve në bashki, mungesën e informacionit dhe kapacitetet administrative të ulëta. Ofrimi i shërbimeve digjitale mbetet i fragmentuar, përveç disa përparimeve në Bashkinë Tiranë. Platforma e-Lejeve perceptohet pozitivisht, edhe pse ka paqartësi për mirëmbajtjen dhe ndarjen e përgjegjësive brenda bashkive.

Bizneset kërkojnë që ankimet dhe shërbimet fiskale të digjitalizohen sa më parë, ndërsa komunikimi dhe përfshirja e tyre në vendimmarrje mbeten të dobëta. Konsultimet treguan gjithashtu sfida lidhur me pasuritë e paluajtshme dhe mungesën e të dhënave të përditësuara në nivel vendor.

Rekomandimet kryesore përfshijnë harmonizimin e politikave midis niveleve qendror dhe vendor, digjitalizimin gradual të shërbimeve duke fuqizuar kapacitetet e bashkive, krijimin e treguesve për matjen e performancës dhe angazhimin më të strukturuar të aktorëve të biznesit në proceset e konsultimit.

IV. Përmbledhje e diskutimeve kryesore

Z. Grant Van Cleve, AmCham, vlerësoi dialogun konstruktiv dhe marrëdhëniet respektuese me institucionet, por theksoi se dhoma ende ndjen mungesë të konsultimit të strukturuar mbi iniciativat ligjore dhe rregullatore. Ai nënvizoi se, megjithë kontributin e komiteteve të AmCham përmes analizave dhe propozimeve, shpesh koha për konsultim është shumë e shkurtër, përgjigjet institucionale mungojnë, dhe një pjesë e konsiderueshme e rekomandimeve nuk merret parasysh, duke krijuar ndjesinë se ekziston ende një problem dëgjimi. Sa i përket çështjeve të qeverisjes vendore, ai shprehu shpresën që qeveria të forcojë mekanizmat formalë të konsultimit, përtëj takimeve dhe diskutimeve informale, duke e theksuar këtë vërejtje në një frymë pozitive dhe me bindjen se marrëdhëniet e mira mund të lehtësojnë përmirësime reale.

Z. Agim Rrapaj, KASH, ngriti shqetësimin e sektorit të bujqësisë lidhur me digjitalizimin, duke theksuar se menaxhimi praktik i 1.8 milion parcelave aktualisht është i pamundur, gjë që ka çuar

në mosdisbursimin e fondeve nga skemat kombëtare. Ai theksoi se kjo sfidë bëhet edhe më urgjente për shpërndarjen e fondeve të Bashkimit Evropian, të cilat bazohen në sipërfaqe dhe kërkojnë digjitalizim të parcelave. **Z. Rrapaj** kërkoi mbështetjen e dy ministrave për krijimin e një strategjie digjitalizimi, duke sugjeruar që të zhvillohet një plan afatgjatë, si dhe një strategji afatshkurtër për periudhën 2027–2030, me qëllim përmirësimin e menaxhimit dhe disbursimit të fondeve.

Ministër Delina Ibrahimaj, theksoi rëndësinë e konsultimit të ligjeve dhe iniciativave ekonomike në kuadër të proceseve të integritetit në BE. Ministria nënvizoi se ligjet të cilat miratohen në këtë kuadër janë përkthim dhe transpozim direkt i direktivave të BE-së dhe duke qenë se ato rishikohen dhe miratohen nga strukturat përgjegjëse në Bruksel, hapësira për ndryshime në ligjet e propozuara nga komentet gjatë fazës së konsultimit publik është shumë e kufizuar. Ajo nënvizoi nevojën për harmonizimin e procesit të konsultimeve midis këshillave të ndryshëm, përfshirë Këshillin Kombëtar Ekonomik, Këshillin e Investimeve dhe këshillat e tjerë ekzistues, si dhe për përfshirjen më të madhe të shoqërisë civile në çështje ekonomike. Ministria theksoi gjithashtu rëndësinë e komunikimit të qartë mbi ndikimin e ligjeve tek komuniteti i biznesit dhe rolin e konsultimeve në përcaktimin e mënyrave më të mira të zbatimit të reformave dhe programeve të zhvillimit ekonomik. Ajo propozoi që këto çështje të përfshihen në agjendën e Këshillit të Investimeve për vitin 2026, duke theksuar nevojën për një plan të strukturuar konsultimesh që siguron bashkëpunim të vazhdueshëm midis qeverisë, biznesit dhe shoqërisë civile, si dhe koordinim më të mirë për adresimin e sfidave dhe ndërtimin e politikave ekonomike efektive.

Në kuadër të digjitalizimit të tokave bujqësore, ministria njoftoi se gjatë vitit të ardhshëm do të organizohet një census i bujqësisë, i cili do të matë dhe dokumentojë të gjithë sipërfaqet bujqësore në vend. Ky census, i cili është kryer për herë të fundit mbi dhjetë vjet më parë, do të shërbejë si bazë për regjistrimin e kartelave të tokave dhe për përgatitjen për tërheqjen e fondeve nga Bashkimi Evropian nëpërmjet Eurostat-it, kur Shqipëria të bëhet shtet anëtar. Ministria theksoi se ky proces ofron mundësinë për të pasur një fotografim të saktë të tokave bujqësore, për të përmirësuar menaxhimin e tyre dhe për të përdorur maksimalisht të dhënat e grumbulluara për qëllime zhvillimi dhe financimi, duke përfshirë harmonizimin me kërkesat dhe standardet e BE-së.

Ministër Ervin Demo, theksoi rëndësinë e regjistrimit të pronave bujqësore dhe lidhjen e tij me nevojat e bashkive, veçanërisht për prodhimin dhe përlllogaritjen e taksës së pronësisë, një nga të ardhurat kryesore të autoriteteve vendore. Ai njoftoi se, duke filluar nga janar 2026, bashkitë do të mund të përdorin të dhënat e regjistruara në kadastër për të llogaritur taksat mbi pronësinë, bazuar në metrat katror dhe parametrat e tjerë, duke iu referuar modelit suedez për ndërtimin e databazës. Aktualisht, databaza është populluar 70%, dhe pritet që deri në vitin 2030 të përfshijë edhe tokat bujqësore, duke përmirësuar menaxhimin financiar të bashkive dhe duke kontribuar në rritjen e të ardhurave vendore.

Z. Zak Topuzi, Shoqata Shqiptare e Turizmit, u shpreh mbi rëndësinë e përfshirjes së sektorit të turizmit dhe agroturizmit në procesin e digjitalizimit. Ai përmendi problemet që hasin investitorët për të marrë certifikatat dhe lejet e nevojshme dhe sugjeroi krijimin e një “dosjeje digjitale të investitorit”, ku të përmbledhen të gjitha dokumentet dhe kërkesat për një projekt investimi, duke u siguruar investitorëve një pasqyrë të qartë dhe të plotë. Gjithashtu, Topuzi nënvizoi nevojën për ndërlidhje midis institucioneve për të shmangur dorëzimin e të njëjtë dokumenteve në vende të ndryshme dhe për të kursyer kohë dhe burime administrative.

Z. Nikolin Jaka, Dhoma e Tregtisë Tiranë, vlerësoi punën e Këshillit të Investimeve në koordinimin me dhomat dhe shoqatat e biznesit dhe në identifikimin e problematikave që ndikojnë

në biznes. Ai theksoi rëndësinë e digjitalizimit dhe komunikimit të qeverisë lokale me sipërmarrësit, duke shtuar se shërbimet digjitale duhet të jenë të zbatueshme, efektive dhe të japin një impakt të qartë për biznesin dhe qytetarët, përfshirë analizën kosto-benefit. Z. Jaka vuri në dukje se, pavarësisht përparimeve në digjitalizim, shumë shërbime mbeten gjysëm të përfunduara dhe procedurat shpesh detyrojnë sipërmarrësit të rifillojnë proceset nga e para, duke theksuar nevojën për trajnim dhe përgjegjësi të personelit që menaxhon sistemet.

Ai ngriti gjithashtu disa problematika në lidhje me taksat vendore duke përmendur taksën e përkohshme për infrastrukturën në arsim dhe taksën për strehimin social, që shpesh interpretohen gabim ose aplikohen në mënyrë jo transparente, gjë që krijon shqetësime për biznesin dhe qytetarët. Z. Jaka nënvizoi rëndësinë e politikave zhvillimore lokale dhe rolin e kryetarëve të bashkive në identifikimin e potencialeve ekonomike të zonave, përfshirë sektorin turistik dhe agropërpunues. Ai përfundoi duke theksuar nevojën që proceset e reformave dhe digjitalizimit të jenë pozitive dhe me impakt të matshëm, duke lidhur këtë me integritetin dhe performancën e sipërmarrësve dhe bashkëpunimin e tyre me qeverinë në një ekonomi konkurruese.

Ministër Delina Ibrahimaj, përqendroi fjalën e saj te digjitalizimi i shërbimeve për biznesin, duke theksuar se, megjithëse u ngritën edhe tema të tjera si niveli i taksave, fokus kryesor i diskutimit ishte përmirësimi i ofrimit të shërbimeve publike përmes digjitalizimit. Ajo rikujtoi procesin e nisur para dy vitesh bashkë me AKSH-in për identifikimin dhe eliminimin e dokumenteve të panevojshme, duke kërkuar input nga sektorët përkatës.

Ministrja vuri në dukje se bashkëpunimi me biznesin dhe inputet e drejtpërdrejta kanë qenë të kufizuara, dhe shumë sugjerime kanë ardhur kryesisht nga stafi i ministrisë, sesa nga vetë biznesi. Qëllimi kryesor i procesit është lehtësimi i jetës për biznesin dhe reduktimi i burokracisë.

Ajo përmendi rastin specifik të Kadastrës, duke shpjeguar se kartelat e pasurisë, të kërkuara nga disa institucione për ofrimin e shërbimeve, nuk mund të përditësohen automatikisht. Kjo për shkak se shërbimi ofrohet me pagesë dhe në mënyrë autonome nga Kadastra, dhe çdo kërkesë për rifreskim të kartelës për periudha të caktuara (p.sh., tre muajt e fundit) duhet të bëhet nga pronari dhe të shoqërohet me pagesën përkatëse. Sistemet institucionale nuk janë të ndërlidhura plotësisht, duke e bërë të pamundur marrjen automatikisht të versionit më të përditësuar nga një institucion tjetër.

Ministrja nënvizoi nevojën për një proces të strukturuar digjitalizimi dhe ndërveprimi midis institucioneve, që të sigurojë përdorim efikas të të dhënave, shmangie të dorëzimeve fizike dhe reduktim të dokumentacionit të dyfishtë. Ajo gjithashtu shprehu gatishmërinë për të hapur një proces të ri konsultimi për çdo dokument shtesë të kërkuar, duke krijuar një kanal rast pas rasti për identifikimin dhe zgjidhjen e problematikave. Ky kanal do t'i lejojë bizneset të raportojnë burokraci të panevojshme, ndërsa institucionet mund të përshtatin procedurat në mënyrë të qëndrueshme dhe të harmonizuar, duke bërë shërbimin më të qashtë dhe efikas për përdoruesit.

Znj. Vasilika Vjero, Bashkia Tiranë, informoi mbi heqjen e taksës për infrastrukturën arsimore, e cila nga viti 2026 nuk do të jetë më barrë për tatimpaguesit, qofshin biznese apo familje. Kjo taksë përfaqëson një të ardhur prej rreth 1 miliard lekësh, e cila do t'i mungojë buxhetit të Bashkisë Tiranë pas heqjes së saj.

Ajo u ndal edhe te taksat për strehimin social, që është 3% për zhvilluesit që ndërtojnë mbi 2,000 metra katrorë, e llogaritur sipas sipërfaqes së ndërtimit ose vlerës monetare të investimit. Kjo taksë

ka siguruar rreth 3.5 miliardë lekë në këto vite, duke u rritur mesatarisht me 600 milionë lekë në vit, dhe përdoret ekskluzivisht për financimin e programeve të strehimit social për kategoritë në nevojë.

Znj. Vjero njoftoi se më 18 dhjetor 2025, Këshilli Bashkiak do të miratojë buxhetin e Bashkisë Tiranë për vitin 2026 dhe në afat mesëm, duke organizuar më parë dëgjesa publike me komunitetin, biznesin dhe grupe të tjera interesi. Këto diskutime do të ofrojnë informacion mbi financimet, të ardhurat dhe shpenzimet e bashkisë, si dhe mbi mënyrën e akomodimit të tyre sipas funksioneve dhe programeve.

Ajo theksoi gjithashtu nevojën për përmirësim të procedurave vendore të mbledhjes së taksave dhe tarifave, duke vënë në dukje se, megjithëse administrata vendore ndjek legjislacionin qendror, proceset duhet të përmirësohen për të rritur efikasitetin dhe harmonizimin me praktikën qendrore.

III. Prezantimi i Sekretariatit mbi gjetjet e anketës mbi klimën e investimeve dhe integrimin evropian

Znj. Diana Leka (Angoni), Sekretariati i KI, raportoi se anketimi i Sekretariatit mbi marrëdhëniet e biznesit me administratën tatimore dhe procesin e integritit evropian tregon përmirësime progresive, veçanërisht në profesionalizimin, qartësinë e raporteve dhe besueshmërinë e të dhënave digjitale. Megjithatë, informaliteti, shmangia e taksave dhe korrupsioni mbeten sfida kryesore. Bizneset raportojnë mungesë informacioni për reformat dhe integrimin, por pritshmëritë mbeten pozitive për rritjen e efikasitetit dhe sigurinë ligjore. Digjitalizimi shihet si instrument kyç për transparencë dhe efikasitet, ndërsa konsultimi dhe përfshirja e bizneseve janë ende të kufizuara, duke evidentuar nevojën për platforma të integruara dhe kanale të qarta komunikimi për të lehtësuar shërbimet dhe reduktuar burokracinë.

Z. Nikolin Jaka, Dhoma e Tregtisë Tiranë, ngriti dy sfida kryesore për biznesin në Shqipëri. Së pari, sistemi i drejtësisë është jashtëzakonisht i ngadaltë, me procese që nga gjykatat e shkallës së parë deri te gjykatat e larta që zgjasin pesë deri shtatë vjet, duke e bërë drejtësinë praktikisht të paarrtshme për bizneset që operojnë me bilance vjetore. Ai sugjeroi rritjen e numrit të gjyqtarëve dhe ndërhyrje të reformës së drejtësisë për të përmirësuar efikasitetin. Së dyti, ai vuri në dukje mungesën e ndërgjegjësimit të bizneseve, sidomos të bizneseve të vogla, për standardet, performancën dhe konkurrueshmërinë, duke theksuar se shumica nuk kuptojnë plotësisht çfarë nënkupton integrimi në tregun evropian. Z. Jaka propozoi që Ministria e Ekonomisë dhe Delegacioni Evropian të angazhojnë ekspertë për të mbështetur dhomat e tregtisë dhe shoqatat e biznesit, duke ndihmuar bizneset të kuptojnë sfidat dhe të plotësojnë standardet për të rritur performancën dhe konkurrueshmërinë në një ekonomi evropiane. Ai shtoi se mungesa e kapaciteteve financiare dhe njerëzore në dhomat dhe shoqatat e biznesit kufizon aftësinë e tyre për të lobuar dhe edukuar bizneset në mënyrë efektive.

Z. Zak Topuzi, Shoqata e Turizmit, u shpreh se një nga sfidat kryesore për sektorin e turizmit lidhet me harmonizimin me standardet e BE-së dhe integrimin në tregun e përbashkët. Ai theksoi mungesën e standardeve në industrinë e hoteleve, bujtinave dhe shërbimeve të tjera, duke përfshirë certifikimin me yje. Për të përmbushur këto standarde, sipas tij, bizneset duhet të bëjnë investime të konsiderueshme; për shembull, për përmirësimin e sigurisë nga zjarri, duhet të investojnë në sistemet e paralajmërimit dhe fikjes automatike, rrugët e evakuimit, si dhe në elementë të tjerë të infrastrukturës, përfshirë pajisjet, mobilimin, sanitaret dhe pajisjet elektrike, për të garantuar përputhshmërinë me standardet e BE-së dhe për të rritur cilësinë e shërbimeve turistike. Z. Topuzi sugjeroi nevojën për grante dhe kredi të buta për të mbështetur adaptimin e industrisë ndaj

kërkesave të standardeve europiane, duke përmendur shembuj nga Greqia dhe vende të tjera si modele të suksesshme. Ai gjithashtu pyeti për masat që qeveria ka parashikuar për të mbështetur këtë proces thelbësor për zhvillimin e sektorit të turizmit.

Znj. Ritva Heikkinen, Delegacioni i BE-së, shprehu vlerësimin për këtë forum diskutimi duke theksuar rëndësinë e dialogut mbi integrimin në Bashkimin Evropian. Ajo ngriti çështjet kryesore si më poshtë:

- Çdo ligj që dërgohet në Bruksel duhet të jetë pjesë e një procesi konsultimi të brendshëm, duke përfshirë shqyrtimin në vend dhe përgatitjen e kohës së nevojshme për shqyrtimin nga Brukseli. Gjithashtu, rregulloret zbatuese janë veçanërisht të rëndësishme dhe duhet të diskutohen dhe konsultohen, sepse ligji kryesor mund të duket i plotë, por zbatimi i vërtetë varet nga detajet e rregulloreve. Konsultimi me biznesin duhet të vazhdojë gjatë gjithë procesit të zbatimit.
- Një problem i cili u konstatua edhe këtu është mungesa e informacionit tek bizneset mbi reformën dhe integrimin në BE, duke përfshirë tranzicionin e gjelbër dhe përgatitjet për standardet e tregut të brendshëm. Përgatitja e bizneseve kërkon vite dhe nuk mund të ndodhë vetëm duke njohur datën e anëtarësimit; ajo përfshin informim të vazhdueshëm mbi ligjet dhe rregulloret, njohjen e standardeve dhe procedurave të tregut të përbashkët dhe përputhjen me kërkesat ligjore dhe teknike për konkurrueshmëri.
- Roli i komunitetit të donatorëve dhe i Delegacionit të BE-së është të mbështesë këtë proces përmes programeve të strukturuar, përfshirë trajnime, informim të vazhdueshëm dhe konsultime me bizneset për zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve zbatuese, me qëllim që bizneset shqiptare të jenë të përgatitura për tregun e BE-së.
- Bizneset nuk janë të informuara mjaftueshëm mbi agjendën kombëtare të reformave dhe prioritetet ligjore, gjë që mund të ndikojë negativisht në besueshmërinë dhe gatishmërinë e tyre për të përfituar nga integrimi. Çdo institucion që përfiton nga agjenda e reformave duhet të ketë një plan aktiv komunikimi për të mbështetur bizneset dhe për të siguruar implementimin efektiv të ligjeve dhe rregulloreve.
- Konsultimet duhet të jenë të vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse, duke përfshirë bizneset e vogla dhe të mëdha, sektorët e ndryshëm dhe nivelet e qeverisjes, për të garantuar që çdo ligj, standard apo procedurë të jetë i kuptueshëm, i qasshëm dhe i zbatueshëm. Bashkëpunimi me Brukselin është i nevojshëm për të siguruar që shqyrtimi i ligjeve dhe rregulloreve të jetë në përputhje me pritshmëritë dhe standardet e BE-së, duke shmangur vonesa ose keqinterpretime.

Minister Delina Ibrahimaj, falenderoi për komentin dhe sqaroi se sa i përket ligjeve që lidhen me procesin e integrit, çdo projektligj dhe akt që duhet miratuar—qoftë për Agjendën e Reformave dhe Rritjes, qoftë për plotësimin e kritereve të kapitujve të mbylljes—kalon përmes një procesi konsultimi të brendshëm para se t'i dërgohet BE-së. Ky proces tashmë ekziston dhe zbatohet. Ajo theksoi se shumica e këtyre ligjeve nuk krijohen nga zero, por janë transpozime të drejtpërdrejta të direktivave të BE-së, gjë që kufizon hapësirën për ndërhyrje.

Megjithatë, ministrja përkrahu plotësisht nevojën për konsultim të akteve nënligjore (si proces aktiv dhe pjesë e planit të punës së ministrisë), të cilat përcaktojnë zbatimin praktik të ligjit. Në këtë Këshill është diskutuar disa herë për këtë çështje. Sot, në qeveri është folur për nisjen e procesit të konsultimit për njërin prej akteve nënligjore më të rëndësishme—si p.sh. rregulloren për kontrollin e investimeve të huaja (FDI screening)—që duhet miratuar brenda këtij viti.

Sa i përket nevojave të komunitetit të biznesit, ministrja nënvizoi se prej dy vitesh ka këmbëngulur për domosdoshmërinë e një programi të posaçëm për përgatitjen e biznesit për integrimin në BE. Kjo përgatitje përfshin informim të vazhdueshëm, asistencë teknike, akses në financim dhe orientim mbi instrumentet që BE-ja ofron për mbështetjen e ndërmarrjeve. Bashkëpunimi me BERZH-in ka mundësuar zhvillimin e një programi trajnimit për konsulentë dhe biznese mbi fondet evropiane në kuadër të Programit të Tregut të Vetëm.

Në Komitetin Strategjik të Qeverisë është miratuar tashmë një program i dedikuar për këtë proces, aktualisht në gjuhën shqipe. Me mbështetjen e GIZ-it, po kryhet një analizë e nivelit të gatishmërisë së komunitetit të biznesit, për të kuptuar pozicionin aktual në raport me kuadrin ekonomik të BE-së. Raporti pritet të përfundojë në fund të dhjetorit 2025, ndërsa hartimi përfundimtar i programit do të jetë gati në tremujorin e parë të vitit 2026. Ky proces duhet të jetë gjithëpërfshirës, duke siguruar angazhimin e çdo aktori me përgjegjësi konkrete, në mënyrë që bizneset të jenë të përgatitura për tregun e BE-së.

Programi parashikon rezultate konkrete, si:

- Informimin e 100% të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe pjesës më të madhe të mikro-ndërmarrjeve;
- Certifikimin dhe akreditimin e rreth 200 konsulentëve dhe ekspertëve, të ndarë sipas sektorëve ekonomikë;
- Realizimin e rreth 500 punëtorive dhe trajnimeve me qasje sektoriale dhe rajonale;
- Promovimin e historive të suksesit;
- Akreditimin, sipas standardeve të BE-së, të rreth 50% të ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha brenda periudhës së projektit;
- Adresimin e barrierave tarifore dhe jotarifore për bizneset, bazuar në analizën e nevojave.

Ministrja nënvizoi se, megjithëse programi është hartuar dhe miratuar në Komitetin Strategjik, ai kërkon financim. Janë zhvilluar diskutime të vazhdueshme me Delegacionin e BE-së dhe donatorë të tjerë, përfshirë mbështetje përmes SASPAC. Pas përfundimit të analizës dhe hartimit të draftit të parë të ndërhyrjeve, do të organizohen tryeza dhe takime me të gjithë aktorët për të përcaktuar mënyrën e mobilizimit të burimeve të nevojshme për zbatimin e programit. Ky proces është kyç jo vetëm për informim, por edhe për suksesin real të ekonomisë shqiptare në tregun evropian.

Siç u vërejt edhe nga diskutimet e sotme, kërkesa nga sektorë të ndryshëm është shumë e lartë, duke treguar urgjencën e këtij procesi.

Znj. Ekaterina Solovova, BERZH, vuri në dukje se, megjithëse ka nisur puna për përgatitjen e bizneseve për Tregun e Përbashkët Evropian, kjo duhet të zgjerohet në mënyrë të konsiderueshme. Ajo theksoi se një nga objektivat strategjikë të BERZH-it në Shqipëri është të rrisë gatishmërinë e sektorit privat për tregun e brendshëm të BE-së. Ky proces kërkon jo vetëm mbështetje institucionale, por edhe iniciativë nga vetë bizneset, të cilat duhet të mbeten kurioze, proaktive dhe të gatshme për të investuar, në mënyrë që të mbeten konkurruese në një treg shumë konkurrues. Znj. Solovova theksoi se disa instrumente financiare janë tashmë në dispozicion—të zhvilluara nga BERZH-i së bashku me BE-në dhe donatorë të tjerë—të cilat ofrojnë financim të përzier për investime në inovacion dhe fusha të tjera thelbësore për përmbushjen e standardeve të BE-së. Këto instrumente mund të aksesohen përmes gjashtë bankave partnere lokale. Ajo shtoi se, përveç financimit, BERZH-i ofron gjithashtu asistencë teknike dhe shprehu gatishmërinë për të thëlluar bashkëpunimin sapo të përfundojë analiza në Ministrinë e Ekonomisë dhe të identifikohen qartë prioritetet për ndërhyrje.

Minister Delina Ibrahimaj, informoi gjithashtu mbi nismën për krijimin e një banke zhvillimi, e cila synon të adresojë nevojën urgjente të sektorit privat për financime të konsiderueshme dhe të buta. Qëllimi është që bizneset të kenë mundësi të përballojnë investimet e nevojshme për përafrimin me standardet e BE-së, automatizimin, modernizimin dhe inovacionin. Për këtë arsye, nevojitet një institucion i dedikuar, i cili të jetë në gjendje të thithë instrumentet financiare të disponueshme në nivel evropian—përfshirë garancitë dhe mekanizmat e tjerë financiarë—dhe t'i kanalizojë ato drejt sektorit privat.

Ajo gjithashtu u ndal tek ngarkesa e lartë e çështjeve administrative në sistemin gjyqësor, duke theksuar se kapacitetet aktuale nuk mund të përballojnë ritmet e nevojshme për zgjidhje të shpejtë. Sipas saj, zgjidhja më efektive është forcimi i mekanizmave të ndërmjetësimit dhe krijimi i kapaciteteve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë gjykatave. Ministria përmendi se ekzistojnë mjete inovative, përfshirë zgjidhje të bazuara në inteligjencën artificiale, të cilat mund të mbështesin këtë proces, dhe se po shqyrtohet mundësia e zhvillimit të një platforme të tillë për të zbutur presionin mbi sistemin gjyqësor dhe për të rritur efikasitetin në zgjidhjen e konflikteve.

Z. Denald George-Tafari, përshëndeti rikthimin e Ministres Ibrahimaj si kryetare të këtij forumi dhe vlerësoi rëndësinë e Këshillit si një platformë unike që bashkon aktorë nga politika, diplomacia, biznesi dhe institucionet publike. Ai nënvizoi kontributin e Sekretariatit, i cili reflektohet në rezultate konkrete të diskutimeve.

Ai u ndal tek sfidat e përmendura nga parafolësit, veçanërisht situata në sistemin gjyqësor, ku rreth 200,000 çështje shqyrtohen nga vetëm 300 gjyqtarë, duke krijuar vonesa të pashmangshme në vendimmarrje.

Lidhur me klimën e biznesit dhe digjitalizimin, ai theksoi se sfida kryesore nuk është teknologjia, por shpërndarja e informacionit të saktë mes institucioneve—informacion ky që duhet të jetë i qasshëm për të gjithë, përfshirë bashkitë, të cilat kanë nevojë për të dhëna të plota mbi klimën e biznesit dhe tërheqjen e investimeve të huaja.

Duke folur në emër të Shoqatës së Biznesit Grek, ai theksoi se shoqatat e huaja ekzistojnë vetëm kur ka biznese të huaja aktive, dhe për këtë arsye ato luajnë rol në promovimin e Shqipërisë dhe potencialit të saj. Megjithatë, ai vuri në dukje se hyrja e korporatave të mëdha është bërë më komplekse, pasi shumë prej tyre funksionojnë përmes fondeve aksionere që, sipas statuteve të tyre, nuk mund të investojnë në vende me vlerësim të ulët të aftësite të tyre për shlyerjen e borxheve nga agjencitë ndërkombëtare si *Standard & Poor's* dhe *Moody's*. Kjo kufizon jo vetëm investimet e huaja direkte, por edhe mundësinë që këto fonde të bëhen pjesë e kompanive shqiptare, edhe kur këto të fundit janë të shëndetshme dhe me potencial të lartë.

Ai përfundoi duke theksuar se shumë kompani evropiane e shohin Shqipërinë si pikë hyrëse për gjithë rajonin, ndaj qeveria—dhe posaçërisht Ministria e Financave—duhet të punojë ngushtë me këto agjenci për përmirësimin e vlerësimit të vendit, në mënyrë që të mundësohet tërheqja e fondeve dhe investimeve strategjike.

Ministër Delina Ibrahimaj, u shpreh se rritja e vlerësimit kreditor të qeverisë nga agjencitë ndërkombëtare si *Standard & Poor's* dhe *Moody's* është një proces afatgjatë që nuk mund të arrihet me një plan të vetëm pune. Përmirësimi i vlerësimit varet nga progresi i vazhdueshëm në shumë fusha, ku qeveria tashmë po ndërhyr. Megjithatë, ajo theksoi se, pavarësisht kohës që kërkon ky proces, Shqipëria ka shënuar përparim të dukshëm gjatë viteve të fundit.

Znj. Diana Leka (Angoni), Sekretariati i KI, falenderoi dhomat dhe AIDA-n për bashkëpunimin në kuadrin e anketimit dhe sugjerimet e dërguara deri tani si dhe kërkoi bashkëpunim për kontributin në përgatitjen e agjendës së KI për vitin 2026. Ajo theksoi tre fusha prioritare për konsultim: eksportet, plani i eksporteve dhe bashkëpunimi me ekosistemin për stimulimin e investimeve të qëndrueshme dhe me standarde. Znj. Leka nënvizoi se po punohet për këto çështje dhe kërkoi nga dhomat që ende nuk kanë dërguar sugjerimet të bëjnë këtë sa më shpejt, para se Sekretariati t'i dërgojë temat për votim.

Mbyllja e mbledhjes

Në mbyllje të diskutimeve, Ministrija Ibrahimaj falenderoi të gjithë pjesëmarrësit për kontributet dhe për rëndësinë e çështjeve të trajtuara. Ajo theksoi se, në bashkëpunim me Sekretariatit e Këshillit të Investimeve, do të hartohet agjenda e punës së KI për vitin e ardhshëm. Prioriteti kryesor do të jetë nxitja dhe përgatitja e biznesit për procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Në përfundim, ajo e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Lista e pjesëmarrjes

Përfaqësues të qeverisë

1. Znj. Delina Ibrahimaj, Kryetare e Këshillit të Investimeve/Ministre e Ekonomisë dhe Inovacionit
2. Znj. Natasha Ahmetaj, Zëvendës Guvernatore e Bankës së Shqipërisë
3. Znj. Laura Plaku, CEO, AIDA

Përfaqësues të biznesit

1. Z. Nikolin Jaka, Kryetar, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë
2. Znj. Ines Muçostepa, Kryetare, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë
3. Z. Diego Pisa, Anëtar Bordi, Shoqata e Investitorëve të Huaj (FIAA)
4. Znj. Antonela Hako, Kryetare, Dhoma Ekonomike e Gruas (DHEG)
5. Z. Grant Van Cleve, President, AmCham Albania
6. Z. Spiro Brumbulli, Sekretar i Përgjithshëm, Shoqata Shqiptare e Bankave, deleguar nga z. Bledar Shella, Kryetar i Bordit Mbikëqyrës
7. Z. Denald George Tafani, President, Shoqata e Biznesit Grek në Shqipëri
8. Znj. Linda Shomo, CEO, EasyPay (*ad-hoc*)
9. Z. Avenir Kika, Anëtar Bordi, Shoqata e Ndërtuesve (*ad-hoc*)

Partnerë ndërkombëtarë

1. Znj. Ritva Heikkinen, Shefe e Bashkëpunimit, Delegacioni i BE-së
2. Znj. Ekaterina Solovova, Drejtore e Zyrës së BERZH-it në Shqipëri
3. Z. Massimiliano Paolucci, Country Manager, Banka Botërore në Shqipërinë
4. Znj. Laura Qorlaze, Përfaqësuese, IFC

Nuk morën pjesë:

1. Z. Ardian Lekaj, Kryetar, Dhoma Shqiptare e Biznesit të Diasporës
2. Z. Davide Rogai, President, Confindustria Albania
3. Z. Nicholas A. Rana, Kryetar, ICC Albania
4. Z. Valer Pinderi, President, Shoqata e Tregtisë Elektronike (AECA)

Të ftuar:

1. Z. Enkelejd Musabelliu, Zv/Ministër i Ekonomisë dhe Inovacionit
2. Z. Endrit Yzeiraj, Zv/Ministër i Financës
3. Znj. Vasilika Vjero, Nën Kryetare, Bashkia Tiranë
4. Z. Philipp Arnold, Zëvendës Shef i Misionit, Ambasada e Zvicrës
5. Znj. Doriana Toro, shefe sektori, Ministria e Financës
6. Znj. Berla Hura, Specialiste, Ministria e Financës
7. Znj. Nevila Repishti, Drejtore e e-Albania, AKSHI
8. Z. Alban Zusi, Kryetar, Shoqata e Eksportuesve
9. Z. Agim Rrapaj, Kryetar, KASH
10. Z. Bardhyl Baltëza, Anëtar Bordi, Unioni i Prodhuesve Shqiptarë/CEO, Edipack shpk
11. Znj. Helga Zogolli, Përfaqësuese, BiznesAlbania
12. Z. Juljan Saraçi, Kryetar, Aleanca e Profesionistëve të Lirë
13. Z. Zak Topuzi, Nën Kryetar, Shoqata Shqiptare e Turizmit

14. Znj. Helisabeta Caco, Drejtore Ekzekutive, Shoqata e Biznesit Grek në Shqipëri
15. Z. Reinaldo Pipiria, Kryetar, Shoqata e Pasurive të Patundshme (NAREA)
16. Znj. Endrita Xhaferaj, Këshilltare e Lartë, BERZH
17. Znj. Ledia Muço, Këshilltare, Delegacioni i BE-së
18. Znj. Marjeta Xhabrahimi (Kodra), Shefe Zyre, Advantage Austria
19. Znj. Silvana Meko, Eksperte, Projekti “Financat Lokale”
20. Z. Artur Papajani, Ekspert
21. Znj. Borana Kalemi, Menaxhere Projekti, Swisscontact
22. Z. Erald Buzi, Konsulent Biznesi, GIZ